

ANASH

APPROACHING SCIENCE

ANALET E ALB-SHKENCËS

Numër special,

Shtator 2013

Botim i Institutit Alb-Shkenca

(www.alb-shkenca.org)

Sfidat e harmonizimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në trojet shqipfolëse

TAKIMI I 8-TË VJETOR NDËRKOMBËTAR I INSTITUTIT ALB-SHKENCA

Tiranë, 29-31 gusht 2013

Botimi i një **reviste informativo-shkencore shqiptare** u bë i domosdoshëm në kushtet në të cilat ndodhet dhe zhvillohet sot shkenca në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në një kohë kur numri i anëtarëve të Forumit Alb-Shkenca (<http://www.alb-net.com/mailman/listinfo/alb-shkenca>) është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Shumica e këtyre anëtarëve janë studiues, pedagogë e studentë pasuniversitarë shqiptarë që kryejnë veprimtarinë e tyre shkencor në vende të ndryshme të botës. Por ka edhe shumë anëtarë të Alb-Shkencës që kontribuojnë në gjallërimin e jetës shkencore në universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Revista e Alb-Shkencës synon të bëjë të njohur në të gjithë botën shqiptare aktivitetin shkencor mjaft të larmishëm dhe shpesh herë shumë cilësor, të studiuesve shqiptarë kudo që ndodhen në botë. Nëpërmjet përzgjedhjes së kujdesshme të shkrimeve, në këtë revistë kemi pranuar për botim vetëm ato shkrime që kalojnë në nanofiltrin e cilësisë. Këtu pra do të pasqyrohet ajo çka është më e shquara e kontributit shkencor shqiptar në këto vite të para të shekullit XXI. Kjo revistë e përgjithshme dhe gjithëpërfshirëse, botim i **Institutit Alb-Shkenca** (www.alb-shkenca.org), është menduar t'i shërbejë një auditori të gjerë intelektualësh e dashamirësish të shkencës në përgjithësi dhe të asaj shqiptare në veçanti. Anëtarët aktualë të Institutit vendosën ta quanin këtë revistë me emrin simbolik: **ANASH—Approaching Science**.

Dikush mund të pyesë: Përse emri ANASH? Ai është shkurtësë e emrit “Analet e Alb-Shkencës” që është edhe emri zyrtar i kësaj reviste. Por fjala shqip “anash” merr një kuptim simbolik fare të veçantë kur vendoset përpara shprehjes në anglisht “Approaching Science”.

Fjala “anash” ka edhe një kuptim të dytë simbolik që reflekton të vërtetën, atë që diaspora intelektuale e shkencore shqiptare është lënë pakëz mënjanë nga vëmendja e politikëbërësve dhe pushtetarëve shqiptarë e ndoshta edhe është harruar për shkak të largësisë e kohës nga trojet e atdheut.

Por e vërteta është që edhe pse ndodhen larg, anash realitetit të përditshëm të shqiptarëve të Ballkanit, intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë atdheut shërbejnë jo vetëm si **ambasadore** të shkëlqyer por vëzhgojnë e ndjekin nga afër ecuritë në çdo fushë të jetës dhe shoqërisë shqiptare. Të organizuar tek Alb-Shkenca ata gjithmonë e më shumë po kërkojnë të marrin pjesë aktivisht dhe të ndihmojnë për një jetë më të mirë të shqiptarëve kudo që ndodhen. Botimi i revistës ANASH është shprehje e qartë e këtij angazhimi serioz të **diasporës shkencore** që po përpiqet përditë e më tepër të kontribuojë në zhvillimet jo vetëm të shkencës dhe arsimit por edhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Revista ANASH përfshin një larmi artikujsh prej fushave nga më të ndryshmet shkencore të përgatitur nga studiues të afirmuar apo studentë pasuniversitarë shqiptarë që kontribuojnë në shkencën botërore edhe në disiplina shkencore nga më të rejat si nanoteknologjia, ekologjia dhe informatika, por edhe në fushat klasike të shkencës si fizika, veterinaria, ekonomia dhe gjuhësia (albanologjia).

Ju urojmë të gjithëve lexim të këndshëm.

Redaktorë shkencorë: Nebi Caka, Prof. Dr., Prishtinë, Kosovë
Nikolla P. Qafoku, Ph.D., Richland, SHBA
Robert T. Magari, Ph.D., Florida, SHBA
Përgatija grafike: Roland Lelaj, Toronto, Kanada

Programi i përgjithshëm i Takimit të 8-të vjetor ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca

Tema bosht:

“SFIDAT E HARMONIZIMIT TË ARSIMIT TË LARTË DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR NË TROJET SHQIPFOLËSE”

Seanca plenare (Salla “Liria” Qyteti Studenti)

Moderator: Prof. Ardian Maçi - Kryetar i Degës së Shqipërisë

Bilanci i aktivitetit të Alb-Shkencës – Prof. Nikolla P. Qafoku, Drejtor i përgjithshëm i IASH

Përshëndetjet e të ftuarve:

Prof. Dhori Kule – Rektori i UT

Znj. Lindita Nikolla – Ministre e Arsimit dhe Sportit në qeverinë ardhshme

Prof. Shpresa Hoxha – Kryetare e degës së Kosovës

Prof. Zeqirja Neziri – Kryetar i degës së Maqedonisë

Sfidat e harmonizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në trojet shqipfolëse

– Prof. Evan Rroço, Prof. Fatos Ylli, Prof. Bajram Berisha, Prof. Emil Lamani, Prof. Mustafa Ibrahim

Albanian Papers: Rritja e rëndësisë së hulumtimeve shkencore shqiptare përmes publikimeve elektronike

– Dr. Eshref Januzaj

Programi i doktoratës “PhD në Shkencat e Ushqimit dhe të Teknologjisë” në Universitetin e Prishtinës, një shembull i harmonizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor me universitet evropiane

– Bajram Berisha, Shemsedin Dreshaj, But Dedaj, Skender Muji, Hysen Bytyqi

Rëndësia e mendimit shkencor në bërjen e politikave qeveritare – Prof. Ardian Harri

Kontributi i IASH në Katedrën e Biotikës së UNESCO-s – Dr. Altin Stafa, Prof. Mentor Hamiti

Aktiviteti Botues i IASH në vite – Prof. Robert Magari

Shkenca shqiptare dhe Instituti Alb-Shkenca

Nga Arjan Th. Kallço*

Nga data 29-31 gusht u zhvillua në Tiranë Takimi i 8-të i Institutit Alba-Shkenca. Një nismë e domosdoshme mbarëshqiptare për të qënë me hapin e kohës me Europën, Amerikën dhe vendet e tjera. Por edhe për vetë faktin se në Shqipëri u instalua një model i shëmtuar i militantizmit dhe klientelizmit në arsim dhe shkencë. Reformat e shumta mbetën thjesht fjalë dhe në vend që të sillnin progresin, e çuan shkollën shqiptare në kahun e kundërt. Nëse dikur shtrohej me të madhe parulla i gjithë populli ushtar, tani parulla është tjetërsuar, i gjithë populli në shkollë. Sigurisht që do të shkonte, po përdor kohën e shkuar, nuk kishte si të ndodhte ndryshe, pas goditjeve sistematike të njëpasnjëshme, me shpresën se gjërat duhet të ndryshojnë. Që të ndryshojë një komb, duhet të ndryshosh themelin e tij, pra arsmen. Ka ardhur koha që politika të mos merret më me reforma të tilla, por të reformojë veten dhe mentalitetin e vet. Populli e dha verdiktin e vet qartë, prandaj i takon politikës t'i hedhë hapat e veta të dukshme dhe të sigurta. Nëse nuk reformon dot veten e vet, nuk mund ta reformojë shoqërinë. Në gjithë periudhën postsocialiste denigrimi i shoqërisë erdhi si rezultat i heqjes dorë nga postulate se përzgjedhja e njeriut është faktor kryesor në zhvillim. Tetë vjet qeverisje e papërgjegjshme solli pasoja me precedentë tepër negative për vendin. Jemi vendi i parë në Europë me 44 universitete private, por pas nuk mbeten as Kosova dhe Maqedonia, kur vendet e tjera nuk i mëshojnë faktorit saisor, por kryesisht cilësor. Skandalet me universitetet private shqiptare tashmë e kanë lënë shijen e hidhur nëpër Europë, niveli i universiteteve shqiptare është në nivelet më të dobta europiane dhe botërore. Të mos flasim pastaj për shkencën, kur vendi u kthye në një fabrikë diplomash. Shkenca shqiptare do të varet shumë nga niveli i shkollës; një shkollë pa kokë, do të prodhojë një shkencë sa për të kaluar radhën. Për këtë mjafton të sjellim shembujt konkretë të konferencave shkencore që zhvillojnë vendet e Europës.

Instituti Alb-Shkenca tashmë po krijon traditën e vet në takime të përvitshme ku marrin pjesë studiues nga trevat shqipfolëse në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni. Në një kohë kur edhe Akademia e Shkencës u përdor si karem për fitime politike, instituti në fjalë nuk ngurroi të ndërmerre një prej nismave që duhet vërtet të përçojë mesazhin se shkenca e vërtetë nuk mund të mbetet peng i një politike të mbrapshtë. Në ditën e parë takimi i zhvilloi punimet tek salla Iliaria në Qytetin student, ku morën pjesë drejtues të Institutit,

të Universitetit të Tiranës, studiues të shumtë, por edhe Ministria e ardhshme e Arsimit Lindita Nikolla.

Fjalën e hapjes, mirëseardhjen dhe falenderimin për gjithë punën në organizimin e konferencës, në emër të stafit të institutit, për të gjithë të pranishmit, e mbajti z. Adrian Maçi, drejtues i degës shqiptare.

Më pas foli drejtori i Përgjithshëm i institutit z. Niko Qafoku i cili vuri në dukje punën e bërë deri më tash, duke hedhur ide edhe për të ardhmen, mes të cilave edhe bashkëpunimi i ngushtë dhe më i frytshëm mes studiuesve shqiptarë kudo që janë në botë, kudo që zhvillojnë punën e tyre shkencore, kudo që japin kontribute të rëndësishme në fushën e shkencës. Një ide tjetër që gjeti mirëkuptimin mes pjesëmarrësve ishte dhe ajo e botimeve në revista të huaja, deri më tash një ëndërr e paralelizuar e studiuesve shqiptarë, por edhe e projekteve shkencore të përbashkëta jo vetëm mes universiteteve dhe institucioneve, por edhe mes vetë faktorit shqiptar.

Ministrja në pritje të marrjes së detyrës, z. Nikolla theksoi se ka ardhur koha që arsimit dhe shkenca të marrin vendin që u takon në Shqipëri. Konferenca të tilla janë tepër të nevojshme dhe kërkoi që bashkëpunimi të mos ndalet këtu, por edhe më tej në takime të tjera që edhe vetë Ministria do të organizojë. Jemi të vendosur – vazhdoi z. Nikolla për një arsim dhe shkencë bashkëkohore. Forume të tilla duhet të mbështeten fuqishëm nga shteti. Natyrisht ishte dalja e saj e parë para studiuesve shqiptarë kudo që ata punojnë dhe inkurajimi i tyre është një fillim i mbarë, duke e lënë të hapur derën e institucionit më të rëndësishëm vendimarrës të arsimit. Qeveria e re ka përpara një mal me probleme të trashëguara nga qeveria paraardhëse, por duhet guxim dhe mençuri që t'i përballojë me sukses këto sfida, e duhet ta fillojë pikërisht nga reformat serioze në arsim. Duhet shëruar disa plagë të thella që besoj edhe vetë z. Rama i përmendi në programin e qeverisë. Nuk kemi më kohë për të humbur.

Më tej folën edhe përfaqësuesit e degëve të Kosovës dhe Maqedonisë që duke vlerësuar punën e bërë në takimet përkatëse me rotacion, vlerësuan faktin se ka botime me vlera autentike, se tubimi ka karakter ndërkombëtar mbarëshqiptar dhe të bashkohen forcat më të njohura shqiptare në Europë. Mendoj se ndoshta në të ardhmen duhet hequr dorë nga karakteri masiv i takimeve, në kërkim të cilësisë së vërtetë. Nëse nuk realizohet kjo, atëherë rrezikojmë ëqë edhe këto takime t'i shndërrojmë në fabrika të sasisë.

**Bashkëpunëtor i gazetes Dielli dhe pedagog në Universitetin "Fan S Noli" Korçë*

Sfidat e harmonizimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në trojet shqiptolëse

1. Procesi i Bolonjës

Deklarata e Bolonjës e nënshkruar në vitin 1999 nga 29 Ministra të Arsimit të vendeve Evropiane është vazhdim i Deklaratës së Sorbonës (1989) dhe përfaqëson dokumentin kryesor udhërrëfyes i Procesit të Bolonjës. Në këtë dokument propozohet krijimi i Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, në të cilën studentet dhe të diplomuarit mund të lëvizin lirisht ndërmjet universiteteve të vendeve të ndryshme, ku kualifikimet paraprahe në një vend vlerësohen të pranueshme për kërkesat e hyrjes për studime të mëtejshme në një vend tjetër.

Qëllimet kryesore për të cilat u ra dakord ishin:

1. "Adoptimi i një sistemi diplomash lehtësisht të lexueshme dhe të krahasueshme". Kjo kërkon që vendet duhet të adoptojnë terminologji dhe standarde të përbashkëta,

2. "Adoptimi i një sistemi kryesisht të bazuar në dy cikle kryesore. Hyrja në ciklin e dytë do të kërkojë përfundimin e suksesshëm të ciklit të parë të studimeve, që zgjat të paktën tre vjet".

Me pas pika 2 u përpunua me tej dhe prodhoi një kornizë të kualifikimeve me tre cikle, të cilat në terminologjinë e sotme janë Bachelor, Master dhe Doktor - për një diplomë e cila ka "dhënë një kontribut përmes hulumtimit origjinal që i zgjeron kufijtë e dijes duke zhvilluar një punë të konsiderueshme dhe tërësore".

2. Harmonizimi në vendet e BE-së

Harmonizimi i arsimit të lartë dhe i kërkimit është një domosdoshmëri për një ecure të përbashkët të këtyre dy fushave aq të rëndësishme për zhvillim ekonomik dhe shoqëror. Domosdoshmëria e harmonizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit është vënë re shumë vite më parë nga shtetet e BE. Ishte pikërisht nevoja për harmonizimin e arsimit të lartë që çoi në hartimin e reformës më të madhe në arsimin e lartë që njihet sot me emrin Procesi i Bolonjës. Ky proces kishte për qëllim bërjen të njëvlefshme dhe të bashkëmatshme të diplomave të universiteteve fillimisht në vendet anëtare të BE dhe më pas edhe në vende të tjera, që aspironin të integroheshin në BE apo

edhe vende të tjera fqinjë. Synimi i kësaj reforme ishte vënia e diplomave në një emërues të përbashkët duke mundësuar hapjen e tregut evropian të punës në të gjithë Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë për të gjithë të diplomuarit e vendeve pjesëmarrëse të kësaj hapësire. Në këtë mënyrë thyhen barrierat e kufijve të shteteve të veçanta duke rritur konkurrencën ndërmjet të diplomuarve. Kjo çon detyrimisht në një rritje të konkurrencës ndërmjet universiteteve, të cilët nga ana e tyre do të tentojnë të zhvillohen duke rritur cilësinë e tyre. Rëndësia e arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik të vendeve është theksuar edhe nga Konferenca e Ministrave të Arsimit të vendeve të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (Bukuresht, 26-27 prill 2012). Në Deklaratën përfundimtare u theksua: "Arsimi i lartë përbën një faktor të rëndësishëm për zgjidhjen e vështirësive që po ndeshim. Sistemet e fuqishëm dhe të përgjegjshëm të arsimit të lartë hedhin themelet e shoqërive intelektuale të zhvilluara. Arsimi i lartë duhet të jetë në bazë të përpjekjeve tona për tejkalimin e krizës, dhe tani më shumë se kurrë". Deklarata thekson gjithashtu se "ne synojmë vendosmërisht sigurimin e nivelit më të lartë të mundshëm të mbështetjes publike financiare për arsimin e lartë, si dhe shfrytëzimin e mundësive të tjera në këtë drejtim, si një investim për të ardhmen tonë".

Vendet e BE, për rritjen e cilësisë dhe harmonizimin e kërkimit shkencor e teknologjik kanë krijuar dhe financuar me shuma marramendëse nëpërmjet Programeve Kuadër. Nëpërmjet këtyre programeve kërkohet nxitje e bashkëpunimit ndërmjet grupeve kërkimore me synim rritjen e cilësisë në të gjithë Hapësirën Evropiane.

Edhe Hapësira Shqiptolëse duhet të ndërmarrë sfidën e harmonizimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor duke zhvilluar një proces të gjere dhe transparent, duke u bazuar në përvojën e deritanishme dhe përvoja të tjera analoge, dhe njëkohësisht duke synuar proceset e njehsimit kombëtar dhe të integritimit evropian.

Tashmë në trojet tona vlerësohet se është momenti që harmonizimi i arsimit të lartë dhe i kërkimit duhet të paraprijë

dhe mbështesë zhvillimet ekonomike dhe shoqërore si dhe do të ndihmojë në proceset integruese të vendeve tona.

3. Gjendja në Arsimin e Lartë dhe kërkimin në Trojet Shqipfolëse // Gjendja e arsimit ??

Për të analizuar gjendjen e harmonizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit në hapësirën shqipfolëse në Ballkan mendojmë se fillimisht duhet të analizojmë se çfarë e lehtëson dhe çfarë e pengon këtë proces.

- Çfarë e lehtëson harmonizimin e arsimit të lartë dhe kërkimit në Trojet Shqipfolëse

Së pari duhet të theksojmë se vendet tona kanë përpara sfida dhe objektiva të njëjta politike, ekonomike dhe të zhvillimit shoqëror, objektiva që duhet të përmbushen në nivel rajonal dhe European. Objektivat e integritetit në Bashkimin Evropian përbëjnë një shtysë të fuqishme për harmonizimin e arsimit të lartë dhe kërkimit.

Gjuha e njëjtë përbën një avantazh të madh në komunikimin ndërmjet pedagogëve, kërkuesve dhe studenteve. Njëkohësisht edhe përmirësimet e infrastrukturës së komunikacionit, apo edhe ato të komunikimit elektronik të bëra vitet e fundit mundësojnë lehtësi në këtë proces.

Pothuajse të gjitha Institucionet tona të Arsimit të Lartë, qofshin këto publike apo private, janë përfshirë në rivlerësimin e kurrikulave dhe planeve mësimore sipas Sistemit të Bolonjës. Vetë Sistemi i Bolonjës përbën një bazë mjaft të mirë për harmonizimin e arsimit të lartë. Nga ana tjetër një pjesë e universiteteve tona janë përfshirë në një numër projektesh, kryesisht të financuara nga fonde të BE si TEMPUS, Programet Kuadër, IPA etj, të cilat kanë dhënë një kontribut të madh në harmonizimin e arsimit të lartë dhe në rritjen e nivelit të kërkimit në këto universitete. Këto veprimtari kanë bërë që një pjesë e stafit pedagogjik e kërkimor të përftojnë një përvojë mjaft të mirë duke rritur ndjeshëm cilësinë e punës së tyre.

Një mundësi mjaft e mirë që do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë dhe harmonizimin e arsimit të lartë dhe kërkimit është prania e një numri të madh studentësh shqiptarë që aktualisht studiojnë në universitete mjaft prestigjioze në vende të ndryshme të botës. Këta studentë përbëjnë një potencial mjaft të madh në të ardhmen për institucionet tona të arsimit të lartë dhe të kërkimit.

- Çfarë e pengon harmonizimin e arsimit të lartë dhe kërkimit

Pavarësisht prej lehtësive të harmonizimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit në Hapësirën Shqipfolëse, mendojmë se janë edhe një numër i madh faktorësh që pengojnë në këtë proces.

Faktori kryesor që pengon është numri jashtëzakonisht i madh i Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) në të gjithë vendet tona. Në Shqipëri funksionojnë 15 IAL publike dhe 44

private, në Kosovë funksionojnë 4 IAL publike dhe 30 private, më Maqedoni funksionojnë 5 IAL publike dhe 14 private. Ky “bollëk” universitetesh dhe shkollash të larta e bën shumë të vështirë harmonizimin e arsimit të lartë. Mjafton këtu të përmendim që ndërmjet këtyre IAL-ve ka ndryshime shumë të mëdha si për nga infrastruktura e mundësitë financiare, ashtu edhe nga përbërja dhe kualifikimi i stafit akademik, për të kuptuar vështirësinë e harmonizimit të nivelit cilësor të këtyre institucioneve.

Këtë gjendje e mundëson mungesa e kriterëve qarta cilësorë në licencimin apo vlerësimin e IAL-ve, pa përmendur këtu faktin që edhe kriteret ekzistuese jo gjithmonë zbatohen me rigorozitetin e duhur si në hapjen e IAL-ve apo filialeve të tyre ashtu edhe në akreditimin e tyre.

Një faktor tjetër që pengon harmonizimin e nivelit cilësor të IAL-ve tona është edhe mungesa (në një numër të madh universitetesh) e kriterëve minimale cilësorë për pranimin e studentëve. Kjo bën që në disa raste niveli i studentëve të jetë shumë i ulët dhe e shoqëruar kjo me një nivel të ndryshëm të mësimdhënies dhe kontrollit të njohurive, rrit në mënyrë të ndjeshme diferencat cilësore në nivelin e diplomave ndërmjet universiteteve tona.

Pasja e një sistemi jo mjaftueshmërisht të zhvilluar informacioni mbi aktivitetin e IAL-ve pengon shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet institucioneve analoge të trojeve shqipfolëse.

4. Harmonizimi në Arsimin e lartë

- Çfarë është bërë

Zbatimi i Sistemit të Bolonjës në pjesën dërmuese të IAL-ve tona është zbatuar për sa i përket hartimit të moduleve, zbatimit të sistemit të krediteve (ECTS) etj. Pjesëmarrja në një numër të konsiderueshëm projektesh TEMPUS ka ndikuar shumë pozitivisht në hartimin e kurrikulave, në përgatitjen e moduleve, në kualifikimin e stafit akademik, deri në përgatitje të diplomave të përbashkëta, që është një arritje mjaft e madhe për ato IAL të cilat janë përfshirë në projekte të tilla.

Nga ana e qeverive të Shqipërisë e Kosovës, janë caktuar kuota studimi për studentë të trojeve shqiptare në disa drejtime studimi, duke filluar nga niveli Bachelor deri në Studimet e Doktoraturës. Ky është një hap me ndikim pozitiv në harmonizimin e arsimit të lartë në trojet shqipfolëse.

Një hap me shumë rëndësi në raport me vlerësimin e nivelit të diplomave dhe që çon drejt harmonizimit të arsimit të lartë është edhe përfshirja e të diplomuarve në disa drejtime të ndryshme studimi (të ashtuquajturat “Profesionet e Kontrolluara”) në provimet e shtetit. Këto provime venë para përgjegjësisë IAL-të e ndryshme që ofrojnë këto drejtime studimi për të rritur nivelin e kërkesave të tyre. Rezultatet e deritanishme flasin për ndryshime të theksuara ndërmjet IAL-ve që ofrojnë drejtime të njëjta studimi.

- Çfarë nuk është bërë (ose jo sa duhet)

Ndërkohë mendojmë se ka akoma mjaft punë për të bërë në raport me harmonizimin në arsimin e lartë. Një ballafaqim i vazhdueshëm ndërmjet IAL-ve për përvojat/qasjet e ndryshme në drejtim të zbatimit të procesit të Bolonjës, mendojmë se ka munguar. Këto ballafaqime duhet të përfshijnë hartimin dhe zbatimin e planeve dhe programeve mësimore, në të gjitha hallkat e tyre si dhe nivelin dhe përvojat e mësimdhënies.

Është e domosdoshme të ketë një harmonizim të kurrikulave të lëndëve bazë, në nivel lokal dhe kombëtar. Përpjekje në këtë drejtim janë bërë, por nuk kanë dhënë rezultatin e duhur. Edhe për gjendjen e teksteve është diskutuar shumë herë. Ka patur disa propozime apo edhe nisma konkrete për harmonizimin e teksteve, të paktën të lëndëve kryesore të trungut bazë të studimeve Bachelor, por interesa të ngushta kanë bërë që këto nisma të mos kenë suksesin e duhur. Shpesh pedagogët duke u fshehur pas pavarësisë pedagogjike, pretendojnë të kenë monopolin e teksteve që ata u rekomandojnë (shpesh – i detyrojnë) studentëve për të studiuar. Një kontroll më i fortë institucional për cilësinë e teksteve që përdoren në universitete dhe për harmonizimin e tyre është i domosdoshëm.

Në arsimin e lartë praktikisht mungon kontrolli për cilësinë e mësimdhënies. Edhe në këtë rast është e domosdoshme të përfshihen vlerësime të stafit pedagogjik dhe të gjenden mekanizma për nxitjen e rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies është e domosdoshme të bëhet pavarësisht prej pavarësisë akademike të pedagogëve.

Numri i madh i IAL-ve mundëson një ndryshim të madh cilësor ndërmjet tyre. Rezultatet e provimeve të shtetit kanë vërtetuar një gjë të tillë. Nga ana tjetër ka shumë të dhëna (informate) që në një pjesë të universiteteve promovohen edhe studentë të cilët nuk marrin pjesë rregullisht në mësim, apo edhe që nuk marrin pjesë fare, Rasti “Bosi” i bërë publik nga mediat e huaja konfirmon se ndodhi te tilla ekzistojnë. Megjithatë edhe në këtë rast, me gjithë ndërhyrjen e MASH – Shqipëri, nuk pati bllokim apo penalizim të Institucionit përgjegjës.

- Cila është gjendja e harmonizimit në Arsimin e Lartë

Nga analiza e mësipërme mund të themi se përpjekjet për një arsim cilësor vazhdojnë dhe ka një tendencë për t’u përshtatur Sistemit të Bolonjës.

Në ambiente akademike dhe profesionale diskutohet për harmonizimin e arsimin të lartë, por proceset dhe përpjekjet janë te pa bashkërenduara. Për shkak të kësaj paqartësie këto përpjekje janë vetëm në fund të procesit (Provimet e Shtetit në Shqipëri)

Prej disa vitesh ka një tendencë sa pozitive aq edhe negative për tu dhënë mundësi të gjithëve për të ndjekur studimet universitare. Kjo tendencë është pozitive në aspektin human, ku secili duhet të ketë të drejtë që të përfitojë nga arsimit i

lartë. Por nga ana tjetër, në realitetin e një sistemi arsimor parauniversitar, që jo gjithmonë e kryen funksionin e vet në shkallën e duhur, dhe kur mungojnë instrumentet filtrues në universitete, rezultojnë që në disa degë, sidomos në ato jo shumë të preferuara, të vijnë studentë të cilët nuk e meritojnë të quhen të tillë. Fakti që nga ana e Universitetit të Tiranës ngrihet me forcë nevoja që të futet në kurrikulat e universiteteve Gjuha Shqipe, flet qartë pikërisht për këtë fenomen.

Numri jashtëzakonisht i madh i diplomave të nivelit Bachelor dhe Master që ofrohen në universitete dhe shkolla të larta, i bën ato shpesh të pabashkëmatshme

Konkluzioni është që ka një përputhje për anën sasiore – sistemi i krediteve (ECTS), por nga ana tjetër ka mospërputhje shumë të mëdha për anën cilësore, jo vetëm ndërmjet shteteve të ndryshme por edhe brenda të njëjtit shtet

5. Harmonizimi në kërkimin shkencor dhe teknologjik

- Çfarë është bërë

Në lidhje me harmonizimin e kërkimit me synim rritjen e cilësisë së tij ka patur nisma të ndryshme të cilat kanë ndikuar pozitivisht në këtë drejtim. Të tilla kanë qenë:

Organizimi i ballafaqimeve dhe konferencave shkencore. Numri i konferencave shkencore, këto vitet e fundit ka ardhur gjithnjë duke u rritur dhe organizimi i tyre bëhet jo vetëm nga IAL_të, por edhe nga një numër organizatash të ndryshme publike, private ose organizata jofitimprurëse. Fatkeqësisht duhet të themi që në disa raste ka një shkallë të lartë formalizmi, mungese të kërkesave cilësore për prezantimin dhe botimin e punimeve, çka dëmton rëndë imazhin e kërkimeve në vendet tona dhe seriozitetin e këtyre organizimeve.

Nga organizma të ndryshme (donatorë të huaj dhe organizma shtetërore) janë financuar një numër i madh projektsh kërkimore. Përfshirja e Shqipërisë në Projektet Kuadër është një hap shumë pozitiv, por fatkeqësisht duhet të themi se përfitimi nga ana e kërkuesve shqiptarë ka qenë shumë i pakët.

Gjithashtu janë financuar nga Ministrinë e Arsimit dhe Kërkimit të vendeve tona projekte bashkëpunimi dypalëshe Shqipëri-Kosovë apo Shqipëri Maqedoni, por këto kanë qenë efemere dhe të përqendruara kryesisht në rajonet kufitare.

- Çfarë nuk është bërë (ose jo plotësisht)

Në Hapësirën Shqipfolëse mungojnë ende politika të koordinuara për financimin e përbashkët të programeve/projekteve të kërkimit me interes të ndërsjellë. Nga ana tjetër financimi shtetëror i kërkimit në përgjithësi dhe i kërkimit me interes dypalësh në veçanti ndodhet në nivele shumë të ulëta

Vërehet një burokraci e tepër në shpenzimin e fondeve shtetërore në kërkim. Këto pengesa burokratike bëjnë që kërkuesi të vihet në varësinë dhe presionin e administratës

së institucionit ku ai bën pjesë dhe në disa raste, si rezultat i kësaj gjendje absurde, një pjese të kërkuesve nuk pranojnë të konkurrojnë për fonde shtetërore për kërkimin.

Ka mjaft pengesa burokratike në përdorimin e fondeve të EU apo donatorëve të tjerë për kërkimin. Në disa raste kërkuesit nuk aplikojnë vetëm për arsye të këtyre pengesave. Në një projekt të fituar nga institucionet shtetërore, pala shqiptare e caktuar për implementimin e projektit u tërhoq dhe projekti rrezikonte të dështonte pasi nuk gjendej asnjë partner shqiptar.

Mungon motivimi i kërkuesit si dhe nxitja e konkurrencës së ndershme ndërmjet tyre. Përveç promovimit në karrierë nëpërmjet botimeve, nuk ka asnjë motivim tjetër për kërkuesit që të kryejnë kërkim cilësor. Në kushtet kur në vendet tona shumë pak bëhet për të luftuar shkeljet e etikës në kërkim, dhe çdokush nëpërmjet shkeljeve të etikës mund të arrijë kushtet e promovimit, atëherë bie edhe arsyeja e vetme e motivimit për një kërkim cilësor. Krijimin i mekanizmave që nxisin konkurrencën e ndershme ndërmjet kërkuesve mendojmë se është një hap i domosdoshëm, së bashku me luftën kundër shkeljeve të etikës në kërkim.

- Gjendja në lidhje me harmonizimin e kërkimit

Gjendjen në lidhje me harmonizimin e kërkimit shkencor në hapësirën shqipfolëse do ta përshkruanim si më poshtë:

Përgjithësisht nivel i ulët dhe i pakoordinuar siç duhet i kërkimit. Pavarësisht se ka mjaft kërkues të veçantë, apo grupe kërkimore që realizojnë kërkim të nivelit të lartë, duke botuar në revista nga më seriozet (me faktor impakti të lartë), duhet të pranojmë që në përgjithësi kërkimi i zhvilluar në vendet tona është i një niveli jo të kënaqshëm. Kjo vjen edhe nga fakti që mungon një bashkërendim dhe një bashkëpunim i grupeve kërkimore në institucione të ndryshme apo edhe brenda të njëjtit institucion. Në mjaft raste mungon deri informacioni i mjaftueshëm mbi aktivitetet kërkimore dhe arrijtjet përkatëse të institucioneve/grupeve të ndryshme kërkimore, duke e vështirësuar akoma më tepër një bashkëpunim të mundshëm.

Në përgjithësi nuk ka një strategji të përcaktuar për fushat prioritare me interes kombëtar apo lokal, ku edhe të përqendrohen fondet e kërkimit, si në rang shtetesh ashtu edhe në rang institucionesh. Në disa raste listat e prioriteteve janë aq të gjata sa përfshijnë të gjitha fushat e mundshme, duke mos përcaktuar praktikisht asnjë prioritet.

Së fundi, theksojmë se në kërkimin shkencor nuk ka harmonizim as në nivel sasi dhe as në nivel cilësor. Nga ana tjetër nuk po arrihet krijimi i sinergjive dhe kapërcimi i “masës kritike” për zhvillimin e aktiviteteve të rëndësishme, që kërkojnë njohuri dhe kapacitete të gjera, të cilat janë të pa disponueshme nga institucionet/grupet kërkimore të veçanta.

6. Harmonizimi në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin

Për të ndryshuar gjendjen si në arsimin e lartë ashtu edhe

në kërkimin shkencor e teknologjik mendojmë se është e domosdoshme të merren disa masa si në nivel vendimmarrjeje ashtu edhe në nivel Institucionesh të Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit që po i përmbledhim më poshtë.

Në nivel vendimmarrjeje politike ???

- Hartimi i një strategjie për harmonizimin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Hapësirën shqipfolëse.

- Hartimi i një plani konkret veprimi për zbatimin e kësaj strategjie, duke përcaktuar aktorët, instrumentet dhe afatet përkatëse

- Hartimi i akteve ligjore të licencimit, akreditimit dhe vlerësimit të IAL-ve publike e private të njësuara dhe më rigoroz se aktualet

- Zbatimi i akteve të mësipërme duke forcuar mekanizmat e vlerësimit dhe akreditimit nëpërmjet

- o rritjes së kualifikimit të personelit dhe

- o pavarësisht së institucioneve vlerësuese dhe akredituese

- Institucionalizimi i procesit të harmonizimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit nga qeveritë dhe kuvendet e vendeve tona

- Harmonizimi i programeve mësimore të arsimit parauniversitar nëpërmjet ngritjes së një qendre të përbashkët për këtë qëllim

- Përcaktimi i fushave prioritare të interesit të përbashkët dhe financimi i projekteve kërkimore në këto fusha.

- Rritja e nivelit të financimit të arsimit të lartë dhe kërkimit

- Lehtësimi i procedurave burokratike të përdorimit të fondeve të kërkimit (si ato qeveritare, ashtu edhe ato të donatorëve të huaj)

Në nivel vendimmarrjeje dhe të institucioneve

- Harmonizimi i planeve dhe programe mësimore për studimet Bachelor, duke patur parasysh diversitetin dhe zhvillimin social të çdo vendi, të cilat tu japin studenteve njohuri shkencore të përafërta dhe të krahasueshme

- Justifikimi i programeve të studimeve Bachelor, me prirje të zvogëlimit gradual të numrit të tyre, duke u orientuar nga nevojat reale të tregut të punës dhe jo nga “tregu i studentëve”.

- Justifikimi i degëve të studimeve Master, nëpërmjet një analize transparente shkencore dhe ekonomike të nevojave aktuale të zhvillimit dhe veçanërisht perspektivave integruese të vendeve tona,

- Organizimi i rregullt dhe periodik i auditiveve dhe i vlerësimeve nga institucione të specializuara,

- Forcimi i grupeve të kërkimit me synim bashkërendimin e kërkimit në fushat prioritare,

- Investime për krijimin e apomodernizimit të infrastrukturave të përbashkëta kërkimore (mjete dhe laboratorë) në fusha/drejtime prioritare,

- Investim në studime të përbashkëta, për të arritur në një proces harmonizimi gjithëpërfshirës

- Hartimi i një terminologjie të përbashkët profesionale,

sipas fushave të ndryshme, të domosdoshme si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkim

- Kontrolli për cilësinë në kërkim dhe mësimdhënie (i brendshëm dhe i jashtëm)
- Kontrolli për etiken në kërkim (i vërtetë dhe jo fiktiv)
- Nxjtja reale e konkurrencës ndërmjet kërkuesve dhe pedagogëve për rritjen e cilësisë në punën e tyre mësimdhënëse e kërkuese.

Gjithçka u paraqit më lart mund të arrihet vetëm në se do të ketë:

Gatishmëri e përpjekje të përbashkëta dhe të koordinuara në të gjitha nivelet, nga punonjësit e departamenteve deri te Rektoratet e IAL-ve, shoqatat shkencore dhe Ministrinë e Arsimit dhe të Kërkimit,

Kujdes që procesi i harmonizimit të shihet jo si një proces homogjenizimi, por si një proces ku konkurrenca shërben për rritjen e vazhdueshme të cilësisë

Përkushtim duke mbledhur në këtë proces të gjitha idetë dhe energjitë,

Transparencë në të gjitha nivelet, ku secili të shprehë qartë idetë dhe mendimet për këtë proces,

Guxim për të krijuar skema dhe procese të reja, për tu shkëputur nga rutina dhe praktika që nuk justifikohen nga ana pedagogjike, ekonomike dhe shkencore,

Vizion për të ardhmen duke tejkaluar pengesat që shfaqen si interesa të çastit,

Investim në studime të përbashkëta, për të arritur në një proces harmonizimi gjithëpërfshirës (nivel departamenti / grupi kërkimor– i cili do të përbejë çelësin e suksesit – nivel universiteti etj),

Përfshirje të organizatave jo-fitimprurëse profesionale ose të specializuara në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit,

Dhe së fundmi mbështetje financiare. Sigurisht që mbështetja financiare është jashtëzakonisht e rëndësishme për harmonizimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, por në rast se do të mungojë dëshira për të realizuar ato çka u përmendën më lart efektiviteti i përdorimit të mjeteve financiare do të jetë shumë i ulët.

7. Bibliografia

1. Garben, S. (2012) The Future of Higher Education in Europe: The Case for a Stronger Base in EU Law, LEQS Paper, No. 50/2012, European Institute, London School of Economics
2. Stamelos, G. Papadiamantaki, Y. Vassilopoulos, A. and Bartzakli, M. (2004) European Higher Education Area (EHAE): The Greek case, Actes of XII World Congress on Comparative Education, La Havane, Cuba, 25-29/10/2004
3. Hemsley-Brown, J.V. and Goonawardana, S. (2007) Brand Harmonisation in the International Higher Education Market,

Journal of Business Research, Vol. 60 pp 942-948.

4. Woldegiorgis, E. T. (2013) Conceptualizing Harmonization of Higher Education Systems: The Application of Regional Integration Theories on Higher Education Studies, Higher Education Studies; Vol. 3, No. 2; pp 12-23.

5. Adelman, C. (2009) The Bologna Process for U.S. Eyes: Re-learning Higher Education in the Age of Convergence, Washington, DC: Institute for Higher Education Policy.

6. Sorbonne Joint Declaration (1998) Joint declaration on harmonisation of the architecture of the European higher education system, by the four Ministers in charge for France, Germany, Italy and the United Kingdom, Paris, Sorbonne, 25 May 1998

7. The Bologna Declaration (1999) Joint declaration of the European Ministers of Education, Bologna, 19 June 1999

8. Ylli, F., Berberi, P. and Qafoku, Ll. (2012) Bashkëpunimi i universiteteve shqiptare dhe sintonizimi i programeve mësimorë / Albanian universities cooperation and syntonization of teaching programs, AKTET Vol 5, No. 4; pp 771-775; Institute Alb-Shkenca

9. Berisha, B. Dreshaj, Sh. Dedaj, B. Muji, S. and Bytyqi, H. (2013) Doctoral study program “PhD in Food Sciences and Technology” at the University of Prishtina, an example of harmonization of higher education and research with European Universities. The 8th International Annual Meeting of Alb-Shkenca Institute, 29-31 August 2013, Tiranë. Albania. Book of Abstracts p. 242.



Programi i studimeve të doktoratës “PhD në Shkencat e Ushqimit dhe të Teknologjisë” në Universitetin e Prishtinës, shembull i harmonizimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencorë me universitet evropiane

1. Universiteti i Prishtinës dhe procesi i Bolonjës

Universiteti i Prishtinës (UP) është institucioni më i vjetër akademik dhe kërkimor-shkencor në Republikën e Kosovës, dhe njëri ndër institucionet më të mëdha dhe më të suksesshme universitare në rajon (1). Universiteti i Prishtinës, njeri ndër institucionet e para universitare në rajon, që nga viti 2001 ka punuar në harmoni me procesin e Bolonjës, edhe pse për arsye politike edhe sot e kësaj dite nuk ka arritur që të jetë pjesë zyrtare e këtij procesi!

Procesi i Bolonjës, bazohet në dokumente të cilat mbështesin krijimin e hapësirës së përbashkët Evropiane të Arsimit të Lartë, në të cilën studentët mund të lëvizin lirshëm ndërmjet universiteteve dhe vendeve të ndryshme, dhe ku kualifikimet e fituara universitare konsiderohen të krahasueshme dhe të pranueshme për vazhdimin e studimeve si edhe për tregun e punës në të gjitha vendet, dhe pjesë e kësaj hapësire të përbashkët të dijes (2,3,4,5). Ky proces, që konsiderohet si reforma më e madhe e ndërmarrë ndonjëherë në historinë e arsimit të lartë, bazohet në kornizën universitare të kualifikimeve me tri cikle, të cilat tashmë janë harmonizuar në titujt Bachelor (BSc), Master (MSc) dhe doktoratë (Dr. Sc. ose PhD).

Bazuar në këto parime themelore të Procesit të Bolonjës, Universiteti i Prishtinës vitet e fundit ka arritur që pjesën më të madhe të programeve Bachelor dhe Master t'i harmonizojë me universitetet më të mira të BE-së. Kjo natyrisht ka ndihmuar shumë që të lehtësohet mobiliteti i studentëve dhe i stafit akademik, duke pasur për bazë programet e studimit dhe sillabuset e ngjashme në mes të Universitetit të Prishtinës dhe universiteteve evropiane (6). Përveç kësaj një harmonizim i tillë i programeve të studimeve, të diplomuarve në UP do t'u mundësojë një qasje më të lehtë në vazhdimin e studimeve, si dhe një depërtim më të lehtë në tregun e punës, në këtë hapësirë, pjesë e së cilës shpresojmë të bëhemi edhe ne së shpejti.

Sipas Ylli dhe bashkëp. (2013), edhe Hapësira Shqipfolëse duhet të ndërmarrë sfidën e harmonizimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor duke zhvilluar një pro-

ces të gjerë dhe transparent, duke u bazuar në përvojën e deritanishme dhe në përvoja të tjera analoge, dhe njëkohësisht duke synuar proceset e njësimi kombëtar dhe të integritetit evropian. Tashmë në trojet tona vlerësohet se është momenti që harmonizimi i arsimit të lartë dhe i kërkimit duhet të paraprijë dhe mbështesë zhvillimet ekonomike dhe shoqërore si dhe do të ndihmojë në proceset integruuese të vendeve tona (7).

2. Universiteti i Prishtinës dhe studimet e doktoratës

Universiteti i Prishtinës është institucion akademik dhe kërkimor-shkencor në të cilin që nga themelimi, përmbi 40 vjet më parë, janë organizuar dhe mbrojtur mijëra disertacione doktoratash.

Kualifikimi i doktorit të shkencave (Dr. Sc ose PhD) nënkupton punë të konsiderueshme dhe kontribut individual shkencor përmes një hulumtimi original e i cili zgjeron kufijtë universalë të dijes duke u publikuar në revista adekuate dhe prestigjioze të fushës specifike shkencore. Numri më i madh i doktorëve të shkencave të kualifikuar në Universitetin e Prishtinës kryesisht janë angazhuar brenda universitetit, ndërsa një numër i tyre më i vogël ka arritur që të angazhohet edhe nëpër universitet e tjera në regjion, por edhe në universitetet evropiane dhe amerikane. Universiteti i Prishtinës mbetet edhe aktualisht institucioni i vetëm në Kosovë, i cili nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) është i akredituar për të organizuar studime të doktoratës.

Që nga viti 2010 studimet e doktoratës në UP janë harmonizuar bazuar në rregulloren e studimeve të doktoratës të Universitetit të Zagrebit. Është përzgjedhur rregullorja e Universitetit të Zagrebit, institucion i regjionit me parakushte të krahasueshme me UP, dhe institucion me të cilin UP ka regjistruar një bashkëpunim të shkëlqyer që nga vitet e para të themelimit.

Me këtë Rregullore për studime të doktoratës në UP rregullohen: struktura dhe mbarëvajtja e studimeve të doktoratës, bartësi i studimeve, format dhe kohëzgjatja e studi-

meve, kushtet e regjistrimit në studime, mënyra e zbatimit të studimeve, mësimi dhe hulumtimi, procedura e paraqitjes, vlerësimi dhe mbrojtja e punimit të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e studentit në studime të doktoratës, të drejtat dhe obligimet e mentorit, mënyra e vlerësimit të cilësisë si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me organizimin dhe mbarëvajtjen e studimeve të doktoratës.

Sipas kësaj Rregulloreje ndër qëllimet kryesore të studimeve universitare të doktoratës janë:

- Krijimi i diturive të reja e relevante dhe zbatimi i tyre;
- Arsimitimi i hulumtuesve dhe individëve me cilësi të larta shkencore në fusha të caktuara shkencore;
- Aftësimi i doktorantëve për hulumtime vetanake dhe për vlerësime kritike të punimeve të tjerëve;
- Arritja e diturive, përvojës dhe shkathtësive, të cilat duhet t'i mundësojnë doktorëve të shkencave që në mënyrë kreative dhe të mbështetur në hulumtime t'i zgjedhin problemet komplekse shoqërore dhe ekonomike;
- Internacionalizimi i punës kërkimore-shkencore në Universitet.

Struktura dhe përmbajtja e studimeve të doktoratës sipas kësaj rregullore është paraqitur e përmbledhur në tabelën 1 dhe 2.

Tabela 1. Struktura e studimeve të doktoratës në Universitetin e Prishtinës

Kohëzgjatja e studimeve të doktoratës	Së paku 3 vite, 6 semestra
Numri i kredive ECTS	180 ECTS
Struktura e programit të studimeve	Ligjërata 30, Seminare 30, Kërkim shkencor 120 ECTS
Forma e publikimit të rezultateve	Së paku një publikim në revistat me „Impact factor“
Sigurimi i cilësisë së studimeve	Akreditim i jashtëm, evaluim i brendshëm, plotësim i formularëve nga ana e doktorantit dhe mentorit gjatë gjithë fazave të studimit.
Regjistrimi i kandidatëve	Konkurs publik
Parakushtet për pranimin e kandidatëve	Të kenë përfunduar Bachelor dhe Master; së paku 300 ECTS kredi
Kriteret e përzgjedhjes	Suksesi (nota mesatare) në nivelin Master, aktiviteti kërkimor shkencor, gjuha e huaj (anglisht)
Mentorët dhe bashkëmentorët	Profesorët ordinar ose të asocuar nga UP dhe Universitetet partnere, të cilët paraprakisht kanë kaluar punëtorinë e mentorimit të organizuara nga UP-ja.

Tabela 2. Raporti i ligjëratave, seminareve dhe kërkimit shkencor sipas semestrave

Semestri i parë, 30 ECTS	Ligjërata nga tri module; të gjitha modulet janë zgjedhore të obligueshme varësisht nga fusha e më vonshme e hulumtimit të kandidatit.
Semestri i dytë, 30 ECTS	Seminare nga tri module; të gjitha modulet janë zgjedhore të obligueshme, varësisht nga fusha e më vonshme e hulumtimit të kandidatit
Semestri i tretë, 30 ECTS	Mbrojtja e suksesshme e projektit hulumtues për punimin e doktoratës para këshillit të Fakultetit
Semestri i katërt, 30 ECTS	Përgatitja dhe publikimi i rezultateve shkencore në një revistë me „impact factor“
Semestri i pestë dhe gjashtë, 60 ECTS	Përgatitja dhe mbrojtja e suksesshme e punimit PhD.

Rregullorja e UP-së parashihet forma të ndryshme të organizimit të studimeve të doktoratës:

- Studimi i doktoratës për të cilin bartës është vetëm një njësi ose universitet;
- Doktoratë e dyfishtë, në të cilën doktoranti i merr dy diploma, për çka është i obligueshëm edhe mentorimi i dyfishtë;
- Studimi i përbashkët të cilin e realizojnë dy ose më shumë universitete, por vetëm një universitet është bartës;
- Modeli i studimeve në të cilat doktoranti regjistron studimin në një universitet dhe merr diplomën e bartësit të studimit, ndërsa kërkimet i zbaton në më shumë vende dhe mund të ketë më shumë mentorë;
- Studimi i bashkuar është programi i dy ose më shumë universiteteve të akredituara, secili universitet merr pjesë në regjistrimin e doktorantëve, ndërsa doktoranti mund të fitojë një diplomë të përbashkët nga të dy ose më shumë universiteteve.

Sipas Rregullores, studimet e doktoratës mund të themelohen dhe të realizohen vetëm në ata lëmenj shkencorë në të cilët institucioni përgjegjës ka arritje të pranueshme ndërkombëtare, respektivisht ka publikime në revista prestigjioze ndërkombëtare. Karakteristikat themelore të

studimeve të doktoratës në Universitet janë hulumtimi dhe të mësuarit nëpërmjet hulumtimit, ndërkombëtarizimi, transparenca, vlerësimi ndërkombëtar i cilësisë dhe konkurrenca ndërkombëtare. Me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe nxitjes së mobilitetit të doktorantëve dhe të stafit akademikë, studimet e doktoratës janë të hapura për çdo formë të bashkëpunimit me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

Me studimet e doktoratës udhëheq „këshilli qendror i studimeve të doktoratës“ i cili përbëhet nga përfaqësuesit e fushave kryesore shkencore të UP-së, dhe kryesohet nga Rektori.

3. Studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Me qëllim të hapjes së një programi të ri të studimeve të doktoratës në UP, autori i këtij publikimi ka filluar përgatitjet në vitin 2008-2009 derisa akoma ka qenë mësimdhënës në Universitetin Teknik të Munihut (UTM) në Gjermani. Pas komunikimeve të shumta me kolegët e Universitetit Teknik të Munihut (Gjermani),

Universitetit të Prishtinës (Kosovë), Universitetit të Gracit (Austri), Universitetit të Granadës (Spanjë) dhe Universitetit Vaasa (Finlandë) filluan përgatitjet për të shkruar një projekt TEMPUS me fokus në fushën e shkencave të ushqimit. Përgatitjen e projektit e ka mbështetur WUS Austria, Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA), Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Kosovës etj.

Në vitin 2010 Projekti Tempus me titull: “Doktorata në Shkencat e Ushqimit dhe të Teknologjisë dhe krijimi i kapaciteteve për reformim të doktoratës në Universitetin e Prishtinës / Kosovë”. (Titulli origjinal “PhD in Food Sciences and Technology and Creating Capacities for PhD Reform at the University of Prishtina / Kosovo”) u aprovua nga Komisioni Evropian dhe filloj të realizoi në UP. Bartës i projektit është Universiteti i Gracit, përfitues kryesor është Universiteti i Prishtinës ndërsa parter kryesor në realizimin e projektit Universiteti Teknik i Mynihut (UTM) dhe Universiteti i Granades (UG).

Në këtë projekt Tempus është përzgjedhur tema nga fusha e shkencave të ushqimit dhe teknologjisë ushqimore duke pasur parasysh faktin se Kosova aktualisht është importuesi më i madh i ushqimit në rajon. Projektin realizohet në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV) ndërkaj partnerët kryesorë lokalë janë Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore (FShMN) dhe Fakulteti i Mjekësisë (FM). Vlera e përgjithshme e projektit është mbi 878.000 Euro, nga e cila shumë për pajisje laboratorike nga fusha e biologjisë molekulare dhe bioteknologjisë janë ndarë rreth 280.000 Euro. Pajisjet tanimë janë lokalizuar në FBV dhe janë në dispozicion për t’u shfrytëzuar për qëllime të hulumtimeve shkencore nga të tri fakultetet e lartpërmendura.

Komponentet kryesore të këtij projekti Tempus janë:

1. Dizajnimi dhe Implementimi i programit të studimeve të doktoratës “PhD në shkencat e Ushqimit dhe Teknologjisë”

2. Modernizimi i strukturës së doktoratës në Universitetin e Prishtinës konform procesit të Bolonjës.

4. Programi i studimeve të doktoratës “PhD në Shkencat e Ushqimit dhe të Teknologjisë” në Universitetin e Prishtinës

Pas përfitimit të projektit Tempus, që në takimin e parë të konsorciumit është filluar puna për realizimin e komponentes së parë: Dizajnimi dhe Implementimi i programit të studimeve të doktoratës “PhD në shkencat e ushqimit dhe teknologjisë”. Programi i studimeve është përgatitur nga Universiteti i Prishtinës si partneri përfitues i projektit, respektivisht nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV) që është bartësi i programit të studimeve. Pas disa

takimeve të njëpasnjëshme me ekspertë të institucioneve partnere të projektit, të cilat janë organizuar në Grac (Austri), Mynih (Gjermani) dhe Granade (Spanjë), programi i studimeve është aprovuar edhe nga ana e konsorciumit të projektit. Pas aprovimit nga senati i UP-së, programi i doktoratës është akredituar edhe nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) dhe ka qenë i gatshëm për implementim.

Në vazhdim një përmbledhje që sqaron rolin, përgjegjësitë dhe obligimet e UP-së nga njëra anë dhe Universitetit Teknik të Mynihut si dhe institucioneve tjera partnere nga ana tjetër, në realizimin e këtij programi:

A) Roli i Universitetit të Prishtinës

- koordinim i përgjithshëm i programit të studimeve;
- dizajnimi i programit të studimeve dhe sillabuseve të moduleve për ligjërata dhe seminare;
- miratimi i programit nga ana e senatit të UP-së;
- akreditimi i programit nga ana e Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA);
- shpallja e konkursit dhe organizimi i panelit ndërkombëtar për përzgjedhjen e kandidatëve;
- përzgjedhja e 15 studentëve dhe regjistrimi i tyre për studime të rregullta në FBV;
- organizimi i ligjëratave (semestri i parë) dhe seminareve (semestri i dytë);
- organizimi i mobiliteteve të studentëve në institucionet partnere;
- organizimi i vizitave studimore të stafit akademik të UP-së në institucionet partnere;
- organizimi i pranimit të docentëve mysafirë nga institucionet partnere;
- organizimi i mentorimit të punimeve të doktoratave të studentëve;
- organizimi i mbrojtjeve të punimeve të doktoratave dhe promovimi i doktorëve të shkencave.

B) Roli i Universitetit Teknik të Mynihut (UTM) dhe institucioneve të tjera partnere

- mbështetje në koordinimin e programit të studimeve;
- mbështetje në dizajnimin e programit dhe sillabuseve të moduleve;
- mbështetje në planifikimin e kërkimit shkencorë dhe internacionalizimin e UP-së;
- pranim dhe mbikëqyrje të 15 studentëve për periudhën 1-3 muaj në institucionet e tyre;
- pranojnë 15 pjesëtarë të stafit akademik të UP-së për vizita studimore në institucionet e tyre;
- ofrojnë 10 bashkëdocentë për ligjërata (semestri i parë) dhe seminare (semestri i dytë);
- ofrojnë 15 bashkë-mentorë për punimet e doktoratave të studentëve të PhD;

Programi i doktoratës “PhD në Shkencat e Ushqimit

dhe të Teknologjisë” do të promovojë qasje internacionale dhe interdisciplinare që janë në harmoni të plotë me:

- Prioritetet strategjike të programit Tempus;
- Strategjinë e zhvillimit të Kosovës;
- Strategjinë e zhvillimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencorë të Kosovës;
- Strategjinë e kërkimit shkencorë të UP-së;
- Prioritetet aktuale të hapësirës së arsimit të lartë dhe kërkimit shkencorë në BE.

Gjenerata e parë e studentëve të doktoratës në këtë program është regjistruar në vitin akademik 2012-2013. Përzgjedhja e studentëve është bërë nga një panel ndërkom-bëtar i përbërë nga përfaqësues të institucioneve partnere të projektit. Pas pjesës me shkrim të provimit pranues kandidatët i janë nënshtruar intervistës individuale gojore në gjuhën angleze.

Profilin tipik interdisiplinar dhe internacional të programit e përcaktojnë edhe të dhënat në vazhdim. Nga 15 studentët e pranuar (8 femra dhe 7 meshkuj), 6 syresh në studimet master kanë mbaruar shkencat e natyrës, 4 mjekësinë humane, 3 mjekësinë veterinare dhe 2 teknologjinë ushqimore. Ndërkaq 8 nga studentët e pranuar, studimet paraprake i kanë kryer në Kosovë, 4 në Shqipëri, 1 në Britani të Madhe, 1 në Zvicër dhe 1 në Bosnje Hercegovinë.

Me ndihmën e palodhshme të partnereve lokalë dhe ndërkombëtarë aktualisht kemi përfunduar me shumë sukses semestrin e parë (të ligjëratave) dhe së shpejti do fillojmë me organizimin e semestrin e dytë (të seminareve).

5. Të veçantat e Programit “PhD në Shkencat e Ushqimit dhe të Teknologjisë” në UP

Ndër të veçantat më të rëndësishme të këtij projekti konsiderohen:

- Nga Projekti Tempus, UP ka përfituar pajisjet laboratorike të teknikës së fundit në lëmin e biologjisë molekulare, në vlerë prej mbi 280.000 Euro, të cilat tanimë janë vendosur në laboratorët e FBV-së;
- Institucionet partnere drejtpërdrejt kanë ndihmuar në përgatitjen e strukturës së programit të PhD-së i cili është i krahasueshëm dhe në harmoni me programet homologe nga universitetet partnere;
- Institucionet partnere do të ofrojnë mësimdhënës për organizimin e të gjitha moduleve të ligjëratave dhe seminareve;
- Institucionet partnere do të ofrojnë vizita studimore në një kohëzgjatje prej 1-3 muaj për të gjithë studentët;
- Institucionet partnere do të ofrojnë vizita të shkurtra studimore për mësimdhënësit e UP-së që janë pjesë e programit;
- Institucionet partnere do të ofrojnë bashkëmentor për të gjithë studentët;

- Institucionet partnere do të ndihmojnë në modernizimin e rregullores aktuale të studimeve të doktoratës në UP;

- Universitetit i Prishtinës në bashkëpunim me institucionet partnere, organizon për herë të parë studime interdisciplinare të doktoratës me karakter të mirëfilltë kërkimor-shkencorë në fushën e shkencave të ushqimit.

6. Perspektiva dhe impakti i Programit të studimeve të doktoratës “PhD në Shkencat e Ushqimit dhe Teknologjisë” në Universitetin e Prishtinës

Me punën e përbashkët me partnerët tanë, gradualisht po i përmbushim objektivat kryesore të projektit që ishin planifikuar deri në këtë fazë. Si një program tipik multidisiplinar dhe ndërdisiplinor i harmonizuar me programet e doktoratave nga universitetet partnere, ka pranuar studentë nga të gjitha fushat e shkencave të natyrës, bioteknologjike dhe të mjekësisë (humane dhe veterinare). Programi PhD promovon me shumë sukses krijimin e rrjetit të bashkëpunimit akademik dhe shkencor në mes të UP-së dhe partnerëve të BE-së me shpresë në për vazhdimin e suksesshëm të këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen (11).

Ekspertët që do të kualifikohen së shpejti nga ky program i studimeve, do të ndihmojnë fuqishëm në përmirësimin e prodhimtarisë ushqimore në Kosovë. Gjenerata e parë, por edhe gjeneratat e ardhshme të këtyre ekspertëve do të ndihmojnë edhe në zhvillimin e kërkimeve shkencore në fushën e shkencave të ushqimit dhe teknologjisë, si dhe në internacionalizimin e kësaj fushe shkencore, që është e një rëndësie të veçantë për shtetin e ri të Kosovës.

Ky program krijon hapësirë dhe bazë për gjenerimin e projekteve shtesë që do të garantonin qëndrueshmërinë e të arriturave kurikulare dhe kërkimor-shkencore nga ky projekt TEMPUS si dhe nga projekte të tjera të ngjashme.

7. Literatura

- (1). Universiteti i Prishtinës, “Tempulli i dijes” Monografi 1970-2012, Prishtinë (2012).
- (2). Joint declaration on harmonization of the architecture of the European higher education system, by the four Ministers in charge for France, Germany, Italy and the United Kingdom. Sorbonne Joint Declaration, Paris and Sorbonne, 25 May 1998 (1998).
- (3). Joint declaration of the European Ministers of Education, The Bologna Declaration, Bologna, 19 June 1999 (1999)
- (4). Garben, S. The Future of Higher Education in Europe: The Case for a Stronger Base in EU Law, LEQS Paper, No. 50/2012, European Institute, London School of Economics (2012).

(5). Woldegiorgis, E. T. Conceptualizing Harmonization of Higher Education Systems: The Application of Regional Integration Theories on Higher Education Studies, Higher Education Studies; Vol. 3, No. 2; pp 12-23 (2013).

(6). Universiteti i Prishtinës, “Pasqyra e planeve mësimore dhe personelit akademik 2010-2011”, Prishtinë (2011).

(7). Ylli F, Rroço E, Berisha B, Lamani E, Ibrahim M. Sfidat e harmonizimit të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencorë në trojet shqipfolëse. The 8th International Annual Meeting of Alb-Shkenca Institute “Challenges on harmonization of higher education and research in Albanian speaking countries” 29-31 August 2013, Tiranë. Albania. Plenary presentation (2013).

(8). Universiteti i Prishtinës, “Rregullorja e studimeve të doktoratës”, Prishtinë (2010).

(9). Berisha B, Dreshaj Sh, Dedaj B, Muji S, Bytyqi H. Doctoral study program “PhD in Food Sciences and Technology” at the University of Prishtina, an example of harmonization of higher education and research with European Universities. The 8th International Annual Meeting of Alb-Shkenca Institute “Challenges on harmonization of higher education and research in Albanian speaking countries” 29-31 August 2013, Tiranë. Albania. Book of Abstracts pp.242-242. (2013).

(10). Tempus Project “PhD in Food Science & Technology & Creating Capacities for PhD Reform at the University of Pristina / Kosovo” (511043-TEMPUS-1-2010-1-AT-TEMPUS-JPCR), (2010).

(11). Për më shumë informacione rreth programit Tempus “Doktorata në Shkenca e Ushqimit dhe të Teknologjisë dhe krijimi i kapaciteteve për reformim të doktoratës në Universitetin e Prishtinës/Kosovë” dhe programit të studimeve të doktoratës “PhD në Shkenca e Ushqimit dhe të Teknologjisë” vizitoni webfaqet ne vazhdim:

1) <http://www.wus-austria.org/project/0/82.html>, WUS Austria (Coordinator).

2) <http://www.phdatup.org>, University of Graz (Grant holder) and

3) <http://uni-pr.edu/Projekte-TEMPUS.aspx>, University of Prishtina (Main Beneficiary).

Shënime mbi Autorin

Prof. Dr. habil. Bajram Berisha, është aktualisht anëtar i Këshillit HERE (Higher Education Reform Experts), anëtar i Këshillit NARIC (National Academic Recognition Information Centre) dhe anëtar i Këshillit Shtetrorë të Arsimit të Lartë (KShALK) të Kosovës. Ka qenë Kryetar i Këshillit Shkencor të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) të Kosovës (2010-2011), anëtar i Këshillit Kombëtarë për Cilësi (KKC) të Agjencisë Kosovare të Akreditimit

(2008-2009), dhe Prorektor për mësimdhënie dhe kërkime shkencore në Universitetin e Prishtinës (2009-2012).

Prof. Berisha është doktoruar, habilituar dhe ka punuar në cilësinë e profesorit të asociuar (Privatdozent) në Universitetin Teknik të Munihut (TUM) në Gjermani prej 1997-2008, ndërkaq që nga viti 2008 është profesor i rregullt në Universitetin e Prishtinës, në fushat shkencore të Biologjisë së riprodhimit, Gjenetikës dhe Bioteknologjisë shtazore. Ai është përfitues dhe implementues i dhjetra projekteve shkencore dhe akademike në Gjermani dhe Kosovë, pjesëmarrës aktiv në qindra konferenca dhe simpoziume shkencore kombëtare e ndërkombetare dhe autor i qindra publikimeve shkencore në revistat më të mira botërore të fushave të tij shkencore.



Në takimin e vitit 2013, ndryshe nga takimet e mëparshme, gjatë seances plenare një numër antarësh të këtij instituti prezantuan ligjërata lidhur me aspekte të ndryshme të temës bosht të takimit: “Sfidat e Harmonizimit të Arsimit të Lartë dhe të Kërkimit Shkencor në Trojet Shqipfolëse.” Midis këtyre ligjëratave, ligjërata ime ishte mbi rolin e mendimit shkencor në formulimin e politikave qeveritare. Shkrimi i mëposhtëm është një variant më i zgjeruar i kësaj ligjërate.

Shkrimi është i organizuar në këto pjesë: Së pari, roli i shkencës në bërjen e politikave qeveritare është përkufizuar bazuar mbi historinë dhe praktikën botërore të marrëdhënieve shkencë-politika qeveritare. Së dyti, shkrimi ofron një shikim të shkurtër historik mbi marrëdhëniet shkencë-politika qeveritare. Së treti, aktualiteti i kësaj marrëdhënie është analizuar shkurtimisht. Së fundi, shkrimi analizon rastin e shoqërisë shqiptare.

Përpara se të filloj me pjesët e përshkruara më lart, si ekonomist nuk mund të mos e përdor këtë mundësi për të parë atë që ne ekonomistët e kemi nga temat më të preferuara të studimit – si individët zgjedhin midis alternativave të ndryshme. Supozoni se ju duhet të zgjidhni midis këtyre dy alternativave:

- Alternativa e parë është të ruani status quo-në ose të ruani standartin e jetesës që keni.

- Alternativa e dytë është e përbërë nga dy mundësi:

Mundësia e parë me një shanc prej 80% që nëse realizohet do të thotë që në afat të shkurtër të ruani standartin që keni, ndërsa në afat të gjatë standarti juaj bie vazhdimisht;

Mundësia e dytë me një shanc prej 20% që nëse realizohet do të thotë që në afat të shkurtër standarti juaj mund të bjerë, por në afat të gjatë standarti juaj rritet vazhdimisht.

Cilën alternativë do të zgjidhni?

Duke iu kthyer pjesës së parë, historia dhe praktika botërore e përcakton vizionin klasik mbi rolin e shkencës në bërjen e politikave qeveritare si vijon. **Shkenca duhet të**

paraqesë vetëm faktet shkencore dhe probabilitetet e tyre, t’i paraqesë ato thjesht, drejtë (troç), ndershmërisht dhe sidomos pa ngjyrosje politike, pa ofuar mbështetje të një ideologjie apo tjetre dhe pa detaje të panevojshme. Me fjalë të tjera, shkenca duhet të thotë të vërtetën – të vërtetën e plotë. Kjo e vërtetë mund të mos jetë e këndshme, mund të mos jetë e pëlqyeshme, mund të mos jetë e pranueshme. Por kjo nuk duhet të ndryshojë faktin që shkenca duhet të paraqesë vetëm faktet dhe probabilitetet - asgjë më shumë, asgjë më pak. Disa mësimet shtesë që praktika dhe historia botërore na mëson janë se çdo individ ka të drejtë të ketë opinionin e tij, por asnjë individ nuk ka të drejtë të ketë “faktet e tij” si edhe që, në lidhje me një problem joshkencor, një shkencëtar është po aq injorant (i mungojnë njohuritë) sa edhe një qytetar i thjeshtë.

Në vazhdim, pak histori mbi rolin e shkencës në bërjen e politikave qeveritare. Për ilustrim do të sjell dy shembuj nga jeta e dy shkencëtarëve të njohur botërorë (por sigurisht të njohur për kontribute të tjera më shumë se sa për faktet që do të përmenden në vijim). Shkencëtari i parë është Isaac Newton (1642-1727). Fakti që do të përmend nuk ka të bëjë me kontributet e shumta të Newton-it në matematikë, fizikë, astronomi, kiminë e atëhershme (alkimi), filozofi, apo shërbimin publik, etj., “... të atij që në gjeni ja kaloi të gjithë racës njerëzore...” Fakti lidhet me qëndrimin e Newton-it ndaj përpjekjeve të autoritetit të kohës, Mbreti James II, për të ndërhyrë me forcë në drejtimin e një prej universiteteve më të famshme të kohës (edhe sot), universiteti i Cambridge-t. Newton-i duke përdorur autoritetin dhe famën e tij si edhe duke inkurajuar (shtyrë) drejtuesit e univeristetit që të mos i bindeshin mbretit por t’i rezistonin atij, arriti të shpëtonte dhe ruante lirinë dhe pavarësinë e institucionit akademik. Newton-i që kishte jetuar gjatë brutalitetit dhe hipokrizisë së shenjtë të autoriteteve të mëparshme si mbreti Charles I dhe Oliver Cromwell-i e dinte se vetëm guximi dhe një front i bashkuar i atyre, liritë e të cilëve rrezikohen janë mbrojtja më efektive kundër politikanëve pa principe.

* Ja një fakt që e vërtetë është disa herë e papranueshme. Në mbasditen e ditës së takimit të IASh-së që u mbajt kjo ligjëratë, një grup nga IASh, i përfshirë edhe unë, do të takohet me disa drejtues të një prej institucioneve të arsimit të lartë. Disa minuta para takimit, “me takt” (por jo bindës) mua më mënjantuan nga ky takim. Kjo është shoqëria shqiptare dhe ndonjëherë duhet të pranosh edhe kosto personale për të “mos i prishur punë” tërë skuadrës apo disa individëve në skuadër.

Shembulli i dytë vjen nga jeta e një shkencëtari tjetër me famë botërore, Carl Gauss (1777-1855), i cilësuar edhe si “Princi i matematikanëve”. Një nga faktet jo aq të njohura rreth Gauss është edhe interesi që ai kishte mbi zhvillimet e politikës botërore dhe veçanërisht aftësia për të lexuar gazetën (edhe kur ato gënjenin) si dhe raportet qeveritare (veçanërisht kur gënjenin) dhe për të “zbuluar” të vërtetën edhe midis përpjekjeve për ta fshehur atë. Gauss, ashtu si edhe Newton, jetoi në një periudhë kur shoqëritë Evropiane po pësonin transformime të shumta dhe shpesh të dhunshme. Një nga këto periudha të dhunshme ishte edhe Revolucioni Francez në fillimet e të cilit u hodh edhe parrulla “... populli nuk ka nevojë për shkencë...”, parrullë e cila sigurisht nuk mund të pranohej nga një shkencëtar si Gauss. Si përgjigje Gauss shprehu kundërshtimin e tij shumë të ashpër ndaj atyre “udhëheqësve të popullit” që e shpien popullin në rrëmujë për përfitimet e tyre personale. Nga ana tjetër, Gauss besonte në ndryshime dhe reforma, por me kusht që ato të ishin inteligjente – “nëse truri nuk mund të gjykojë cilat reforma janë inteligjente, cili organ mund?” besonte Gauss.

Edhe në ditët aktuale shkenca vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në bërjen e politikave qeveritare. Shembujt janë të shumtë. Për shembull në Britaninë e Madhe gjatë dekadës së fundit ka patur një mbështetje të fuqishme të qeverisë për të nxitur përdorimin më efektiv të shkencës në bërjen e politikave dhe ligjeve. Që nga 2001 Bashkimi Evropian midis të tjerash thekson vënien e “shkencës së përgjegjshme” në zemër të bërjes së politikave qeveritare. Shembuj të ngjashëm vijnë edhe nga vende të tjera si Australi, Zelandë e Re, Kanada, etj. Ajo që vlen për t’u theksuar në lidhje me rolin e shkencës në bërjen e politikave qeveritare në ditët e sotme është se një nga çështjet ku fokusohet roli i shkencës është ndryshimi i klimës në tokë dhe roli i aktivitetit njerëzor në këtë ndryshim. Pra, roli i shkencës në bërjen e politikave qeveritare ka kaluar përtej çështjeve me natyrë thjesht kombëtare në ato me natyrë globale. Natyrshëm lind pyetja, po në shoqërinë shqiptare çfarë roli luan mendimi shkencor në bërjen e politikave qeveritare?

Analizën e rastit të shoqërisë shqiptare po e filloj me një shembull diskutimi nga forumi Alb-Shkenca. Në një mesazh (mesazhi është kopjuar ekzaktësisht nga forumi, gabimet ortografike dhe theksimet janë të autorit/es së mesazhit) në forum autori/ja shkruan “Shprehja e Kryeministrit Berisha se Demokratët e vitit 1924, që rrëzuan me armë klikën feudale ishin aventurier,ë nuk i përgjigjet të vërtetës historike dhe ul prestigjin e vetë Berishës si personalitet politik. Edhe unë kërkoj që Kryeministri në ikje të nderojë kombin e vet dhe korifejtë e tij demokratë duke pranuar se është shprehur gabim, si mjek nga profesioni dhe larg historisë së Shtetit shqiptar”. Më tej autori/ja vazhdon: “Shtoj se Fan S. Noli, Luigi Gurakuqi, Padre Gjergj Fishta, Stavro Vinjau, Shefqet Korça, Bajram Curri, etj, ishin demokratë të mëdhenj të Kombit, kundër obskurantizmit

feudal te tipit mesjetar që mbartej nga latifondistët e medhenj, të perfaqësuar politikisht nga monarku potencial Ahmet Zogu i pare.”

Mesazhet e mësipërme japin një tablo mbizotëruese të marrëdhënieve mendim shkencë–autoritete qeveritare në shoqërinë shqiptare. Kjo marrëdhënie zakonisht karakterizohet nga këto tipare:

- Debatë për një çështje shkencore (në këtë rast historike) fillohet nga politikanin;
- Politikani shpreh opinionin e tij, “jo fakte”;
- Një shkencëtar/e (në këtë rast jo-historian) përsërit gabimin e politikanit (dy herë), së pari sepse shprehet për një çështje shkencore jo të profilit, pra ka të njëjtën nivel njohurie si edhe çdo qytetar dhe së dyti, sepse shpreh opinionin e tij/saj, “jo fakte”.

Një përgjigje alternative në këtë rast mund të ishte si vijon. Si jo-historian do të propozoja një hipotezë për një studim shkencor për këtë çështje shkencore (histori). Hipoteza është “A. Zogu dhe F. Noli (me mbështetësit e tyre) i përkisnin kampeve të ndryshme ideologjike, por të përbashkët kishin interesat e vendit”. Një fakt historik lidhur me këtë hipotezë ekziston: ata (Zogu dhe Noli) bashkëpunuan për të mirën e Shqipërisë.

Duke qenë se unë jam ekonomist, do t’i kthehem rastit të shoqërisë shqiptare duke u fokusuar tek ekonomia. Shumë është folur dhe shkruar për ekonominë gjatë periudhës së tranzicionit. Në këtë shkrim do të përdor një analogji të thjeshtë për të kuptuar gjendjen e ekonomisë shqiptare. Të gjithë shikuesit e lojrave verore olimpike të 2012-ës sigurisht që e mbajnë mend vrapuesin afrikano-jugor Oscar Pistorius i cili mori pjesë në garën e 400m dhe stafetën 4x400m. E veçanta e tij është se ai i ka të dyja këmbët të prera nën gju (i pari vrapues me këtë gjendje që merr pjesë në lojrat olimpike) dhe përdor këmbë metalike për të vrapuar.



Mendojeni tani Pistorius pa këmbë metalike. A mund t’i kërkohej atij të konkurojë njëlloj si në rastin kur përdor këmbë

metalike kundër atletëve më të mirë në botë?

Vetëm me një logjikë të tillë (të mangët) mund t'i kërkohej ekonomisë shqiptare të konkurojë në një ekonomi gjithnjë e më shumë globale kur asaj i mungojnë të dyja këmbët – e drejta e pronës private dhe liria ekonomike për të gjithë.

Ndërsa e drejta e pronës është thjesht e kuptueshme për të kuptuar rolin e lirive ekonomike në rritjen dhe zhvillimin ekonomik po përdor si analogji sasinë e ujit që rrjedh nga një shishe. Sasia e ujit që rrjedh nga shishja simbolizon nivelin e aktivitetit ekonomik. Kur gryka e shishes është e ngushtë, si në foton më poshtë, sasia e ujit (niveli i aktivitetit ekonomik) është mjaft e vogël. Gryka e ngushtë e shishes në këtë rast simbolizon kufizimet që qeveria vendos mbi aktivitetin ekonomik, nënkupto kufizimet lidhur me investimet, kreditimin, licensimet, praninë e monopoleve, etj.



Për më tepër, ky aktivitet i kufizuar është i dominuar nga biznese të lidhura ngushtë me politikën. Këto biznese të kontrolluara nga politika gjithashtu mund të quhen biznese “të këqija” ose “të dobëta” pasi pjesa dërrmuese e fitimeve të ligjshme - nga aktiviteti ekonomik, apo të paligjshme - nga pushteti politik nuk investohen në aktivitete prodhuese ekzistuese apo të reja por ose “fshihen nën dyshek” ose nxirren jashtë vendit. Pasoja e këtyre vendimeve, sigurisht është negative për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

Duke iu kthyer analogjisë së shishes, mendoni tani nëse ja presim grykën e ngushtë shishes dhe efektin që kjo do të sjellë mbi rrjedhën e ujit – nënkupto aktivitetin ekonomik.

Është mëse e qartë se heqja e kufizimeve artificiale të përmendura më lart do të rezultonte në një rritje disa herëshe të aktivitetit ekonomik, më shumë biznese private, më shumë punësim, më shumë të ardhura për biznesin privat por edhe për sektorin publik, me një fjalë standard më i lartë jetese për të gjithë.

Punime kërkimore-shkencore ekzistojnë, disa madje të bëra specifikisht për t'i ofruar informacion qeverive shqiptare, që tregojnë se ekonomia shqiptare nuk është një ekonomi tregu funksionale, se monopolet e lidhura me politikën po ja marrin frymën dhe shkatërrojnë degë të ekonomisë, se moszgjidhja e problemit të pronësisë së tokës frenon investimet në bujqësi dhe sektorë të tjerë prodhues të

ekonomisë, se faktorët e rritjes për ekonominë shqiptare janë kryesisht faktorët të jashtëm dhe faktori më kryesor janë të ardhurat e dërguara nga emigrantët, që përqindja e popullsisë në varfëri dhe varfëri ekstreme vjen duke u rritur, etj. Por fatkeqësisht, në vend që ky mendim shkencor të përdoret për formulimin e politikave qeveritare që do të zgjidhin këto probleme të rëndësishme strukturore të ekonomisë shqiptare, ky mendim shkencor thjesht injorohet. Edhe më keq akoma qeveritë e ndryshme kanë pretenduar dhe pretendojnë absurditete (duke u bërë qesharakë) si rritje ekonomike ndonjëherë më të madhe se të gjithë vendet Evropiane, vendi i vetëm në Evropë që nuk ndjeu recension nga kriza e fundit botërore – nuk di ç'të bësh kur dëgjon gjëra të tilla, të qash apo të qeshësh? Duke pasur parasysh se këto deklaramë mbështeten në të dhënat e vetë qeverisë mjafton të kujtojmë rastin e Gauss-it të përmendur më sipër dhe reagimin e tij ndaj raporteve dhe të dhënave të pavërteta qeveritare.

Duke u nisur nga sa më sipër shihet qartë se politikë-(mos)bërja nuk është pa pasoja dhe si rrjedhim disa pyetje dalin llogjikisht:

- Pse nuk kanë ndryshuar gjërat gjatë 22-23 viteve të fundit?
- A kanë interes bërësit e politikave që të ndryshojnë gjërat?
- Çfarë ndodh nëse gjërat nuk ndryshojnë?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve do t'i referohem një libri, më saktë vlerësimeve të bëra këtij libri, të botuar vitet e fundit me titull: “Përse dështojnë kombet” me autorë Daron Acemoglu (MIT) dhe James Robinson (Harvard). Ky libër duhet të studiohet nga çdo student shqiptar i shkencave sociale dhe atyre humane dhe është mirë të lexohet nga çdo qytetar shqiptar që është e/i interesuar për të ardhmen e kombit shqiptar. Vlerësuesit e librit përfshijnë midis tyre pesë fitues të çmimit Nobel për ekonominë, dhe shumë ekonomistë të njohur nga shkolla të njohura si Harvard, Yale, Stanford, MIT, etj. Në vazhdim disa nga vlerësimet/komentet:

“... freedom makes the world rich...” (Liria e bën botën të pasur);

“... especially private property and competition...” (veçanërisht prona private dhe konkurrenca e lirë);

“... inclusive political institutions in support of inclusive economic institutions... key to prosperity” (institucionet politike gjithëpërfshirëse në mbështetje të institucioneve ekonomike gjithëpërfshirëse – çelësi për përparim e mirëqenie);

“It's the politics stupid! ... powerful elites rig the rules to their benefit at the expense of many” (është politika budalla! ... elita të fuqishme shtrembërojnë rregullat për të përfituar në kurriz të shumicës; - vlerësimi dhe komenti im i preferuar;

“Keep those people in check with effective democracy or watch your nation fail” – mbajini këta njerëz nën kontroll me një demokraci efektive ose shiheni kombin tuaj të dështojë;

“... favorable institutions, progressive innovation, and economic success or ... repressive institutions and eventual decay ...” (institucione favorizuese, inovacion progresiv, dhe sukses ekonomik ose ... institucione shtypëse (frenuese) dhe rënie e pashmangshme.)

Duke pasur parasysh vlerësimet dhe komentet e mësipërme dhe duke iu kthyer realitetit shqiptar është fakt tashmë se:

- Elita të fuqishme kontrollojnë politikën dhe ekonominë;

- Ato nuk kanë interes që gjërat të ndryshojnë.

- Si rrjedhim konkluzioni: **Kombi shqiptar është nisur rrugës drejt dështimit.**

E rëndësishme është për çdo person që e konsideron veten si pjesë e “trurit” të shoqërisë shiptare dhe është e/i interesuar për të ardhmen e kombit dhe të tyren si pjesë e këtij kombi që të kuptojë se është jetike që për kthesën të fillojë duhet filluar me: mjaft ja lamë fjalën elitës për gjithçka. Veç kësaj çdo person mund të fillojë me pyetjen drejtuar vetes: Cili është kontributi im që kombi ka arritur në këtë pikë? Por

njëkohësisht është e rëndësishme të kuptohet se është jetike për kombin që elita politike të përfshijë “trurin” në bërjen e politikave qeveritare dhe për këtë ka shumë të ngjarë që ajo do të duhet të detyrohet. Le të shërbejë si nxitje dhe udhëzues për këtë mësimi nga rasti i Newton-it: **Guximi dhe një front i bashkuar janë mbrojtja më efektive kundër politikanëve pa principe.**

Në mbyllje dua t’i rikthehem edhe një herë pyetjes së shtruar në fillim të shkrimit:

- Alternativa e parë është të ruani status quo-në ose të ruani standartin e jetesës që keni.

- Alternativa e dytë është e përbërë nga dy mundësi:

- Mundësia e parë me një shans prej 80% që nëse realizohet do të thotë që në afat të shkurtër të ruani standartin që keni, ndërsa në afat të gjatë standarti juaj bie vazhdimisht;

- Mundësia e dytë me një shanc prej 20% që nëse realizohet do të thotë që në afat të shkurtër standarti juaj mund të bjerë, por në afat të gjatë standarti juaj rritet vazhdimisht.

Cilën alternativë do të zgjidhnit?

Në pyetjen e mësipërme shanci prej 20% për mundësinë e dytë është thjesht një numër i rastësishëm. Numri real mund të jetë edhe 0 nëse të gjithë bëjmë si deri tani – asgjë dhe vetëm presim nga elita politike. **Por nga ana tjetër ky numër mund të jetë edhe 100 – nëse të gjithë angazhohemi.**

Kontributi i Institutit Alb-Shkenca në Katedrën e Bioetikës UNESCO

Rrjeti ndërkombëtar i Katedrës së Bioetikës pranë UNESCO-s, me seli në Qendrën Ndërkombëtare të Legjislacionit Shëndetësor dhe Etikës së Universitetit Haifa, Izrael, u krijua më 24 qershor 2001 mbi bazën e një marrëveshje nënshkruar prej Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s të atëhershëm Prof. Koïchiro Matsuura dhe Rektorit të Universitetit Haifa, Izrael, Prof. Amnon Carmi.

Qëllimi i këtij Institucioni është të koordinojë dhe të stimulojë një rrjet ndërkombëtar për promovimin dhe mësimdhënien e etikës mjekësore, dialogun mes institucioneve të arsimit të lartë si në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim, dhe përpilimin e një teksti mësimor të përditësuar për mësimdhënien e etikës mjekësore, tekst i cili do të përmbushë nevojat universitare në institucionet e vendeve anëtare të Rrjetit.

Egziston një nevojë urgjente në rritje për promovimin e etikës mjekësore në mënyrë të artikuluar, sidomos në institucionet e arsimit të lartë. Kjo nevojë është pasojë e disa proceseve shoqërore dhe shkencore aktualisht në evolucion, mes të cilave përmendim reformat e sistemeve shëndetësore, globalizimi i shëndetësisë, nevoja për shpërndarje më efikase të burimeve shëndetësore (teknike dhe njerëzore), rritja e nivelit të informacionit mjekësor të pacientëve, rritja masive e përdorimit të teknologjisë mjekësore, rritja potenciale e nivelit të shërbimeve mjekësore si pasojë e arritjeve të reja shkencore dhe gjenerimi i dilemave të reja bioetike.

Rrjeti ndërkombëtar i Katedrës së Bioetikës pranë UNESCO-s, përbëhet aktualisht nga 35 njësi të cilat përfaqësojnë 33 shtete të ndryshme në të 5 kontinentet, mes tyre edhe Shqipëria dhe Maqedonia (www.unesco-chair-bioethics.org/UI/C01.aspx).

Njësitë e Shqipërisë dhe Maqedonisë, përveç platformës operative mbi të cilën veprojnë, kanë të përbashkët edhe faktin se të dyja ato janë themeluar dhe drejtohen nga anëtarë të Institutit Alb-Shkenca (IASH).

Konkretisht, Njësia e Maqedonisë është themeluar në dhjetor 2007 nga Prof. Mentor Hamiti, Fakultetit i Shkencave Bashkëkohore të Universitetit të Europës Juglindore në Tetovë dhe anëtar i Seksionit të Shkencave Inxhenerike dhe Teknologjisë së Informacionit të IASH.

Njësia e Shqipërisë është krijuar në maj të vitit 2012 nga Dr. Altin Stafa, mjek neuroradiolog në Spitalin Maggiore Bologna, Itali dhe drejtues i Seksionit të Shkencave Mjekësore të IASH.

Njësia e Maqedonisë

(www.unesco-chair-bioethics.org/UI/C02.aspx?uid=C8CC695D3AA68CD5)

Me një aktivitet të konsoliduar në gjashtë vite veprimtarie, Njësia e drejtuar nga Prof. Mentor Hamiti, e ka shtrirë aktivitetin e saj të promovimit të etikës edhe përtej fushës mjekësore.

Që nga fillimi, Njësia ka krijuar Komitetin Udhëheqës me gjithsej 11 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të 5 fakulteteve të ndryshme në kuadër të UEJL-së. Me këtë është siguruar që në kuadër të Njësise të ketë profesionistë të lëmive të ndryshme, si nga: sociologjia, drejtësia, ambienti jetësor dhe shëndeti, ekologjia, administrimi publik dhe biznesi, komunikimi, shkencat bashkohore, etj. Kurse, kuadrot nga shkencat mjekësore, shoqatat joqeveritare dhe institucionet tjera të interesuara për bashkëpunim, janë inkuadruar në Komitetin e zgjeruar të Njësise. Përbërja e këtillë e Njësise, e cila posedon edhe zyrën e veçantë në kuadër të UEJL-së (Zyra: 305.05, e-mail: ethics@seeu.edu.mk, tel. +389 044 356-175), ka siguruar udhëheqjen e aktiviteteve për promovim të vlerave etike, gatise në të gjitha sferat e jetës.

Janë për t'u përmendur disa nga aktivitetet e shumta, të realizuara nën udhëheqjen e kësaj Njësie:

- Publikimi dhe distribuimi i posterëve dhe broshurave me moton "Help yourself and others, improve ethical values in our society" (2008), të cilët mjaftë pozitivisht u vlerësuan nga Njësia Qendrore e Bioetikës me seli në Izrael dhe nën udhëheqjen e saj, u organizua shërndarja deri te të gjitha njësitë e Rrjetit Ndërkombëtar të UNESCO-s.

- Përkthimi i librit të Prof. Amnon Carmi "Inform Consent" në gjuhën shqipe "Pëlqim i Informuar" (2008), i trajtuar si literaturë që i ka munguar bibliotekës shqiptare dhe që i'u ofrohet me qasje të lirë lexuesve shqiptarë!

- Botimi i librit "Etika dhe Teknologjitë e Informimit" (2009), nga 4 autorë që njëkohësisht janë edhe anëtarë të

Komitetit Udhëheqës të Njesisë, i trajtuar si nevojë e kohës për ta patur në gjuhën shqipe dhe si i kushtëzuar nga zhvillimi rapid i teknologjive aktuale!

- Organizimi periodik i debateve dhe tryezave të diskutimit në UEJL (2009-2011), me përkthim simultan në tri gjuhët zyrtare në UEJL (shqip, anglisht dhe maqedonisht), konform ambientit multietnik ku jetojmë. Tema të trajtuara: Ethics importance in SEEU, Global crisis and the need for ethics, Euthanasia, Fertilization and Kloning, Ethical principles and dilemmas in communication, Eco-Ethics, Intellectual property, Privacy, etj.

- Përgatitja, miratimi dhe publikimi i Kodit Etik të Universitetit të Evropës Juglindore (2012), në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare partnere: USAID, TEN-network, EDC dhe YEF, që aktualisht konsiderohet si më se i nevojshëm për ta pasur të gjitha universitetet, qoftë private ose publike.

- Ofrimi i lëndëve të etikës në kuadër të programeve të ndryshme studimore deridiplomike dhe diplomike në UEJL (2011-2013), si: etika e komunikimit, etika e biznesit, etika e administrimit publik, etika dhe TI, etj. Në çrast, ligjëruesit janë njëkohësisht edhe anëtarë të Njesisë por edhe të IASH-it.

- Numri i punimeve shkencore të prezantuara dhe të publikuara në konferenca dhe revista të ndryshme ndërkombëtare nga lëmia e etikës (2009-2013), që është në rritje e sipër. Mbi 20 punime ofrohen nga Njësia, gjegjësisht anëtarët e saj që njëkohësisht janë edhe autorë, si: Ethical Use of Information Technology in Medical Faculties, Teaching with Technology, Internet Ethics and Education, Challenges of Computers and IT in the Coming Decade, Ethics in Political Communication: Macedonian Members of Parliament Should also Learn Ethics, Ecology of the soul, Media practice – principles and practices in Macedonian journalism, Professional Ethics and Abuse, Moral and legal responsibilities–dilemmas faced in pharmacy–experiences from the Republic of Macedonia, Euthanasia for patients with incurable disease- cancer, etj.

- Memorandume bashkëpunimi të nënshkruara me asociacione të ndryshme të vendit dhe ndërkombëtare (USAID, EDC, YEF, etj) si dhe pjesëmarrja në projekte të përbashkëta (TEN, <http://ten.edc.org/>; Ethics Web, <http://ethicsweb.org/>; AEP, <http://www.aepmak.org/>).

Në vazhdimësi, Njësia vazhdon mbajtjen e takimeve të rregullta, shqyrton mundësitë për aplikime në projekte të ndryshme dhe zgjeron bashkëpunimin me të gjitha institucionet e interesuara në vend dhe më gjerë. Vlenë të theksohet, se në agjendën e aktiviteteve për vitin 2013 evidentohet themelimi i Nën-Njësive që do të veprojnë në kuadër të kësaj Njësie, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Maqedoni. Në themelim e sipër janë: “Njësia e Etikës

Mjekësore”, në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe “Etika dhe Literatura”, në Universitetin Goce Delçev të Shtipit.

Pra, veçantia e veprimtarisë së Njesisë së Maqedonisë dhe njëkohësisht një vlerë e shtuar e saj, është pa dyshim konteksti multi-kulturor social në të cilën kjo njësi vepron.

Njësia e Shqipërisë

(www.unesco-chair-bioethics.org/UI/C02.aspx?uid=C8CF061B05B50695)

Aktiviteti themelues i kësaj Njësie duhet konsideruar Konferenca ndërkombëtare “Ethics in Medicine” organizuar nga Seksioni i Shkencave Mjekësore të IASH në 31 mars 2012. Kjo Konferencë, e para ndërkombëtare e këtij lloji organizuar në Shqipëri, pati të ftuar ekspertë nga 7 vende të Europës si dhe nga Izraeli, të cilët trajtuan dimensione thelbësore të etikës mjekësore bashkëkohore. (Kumtesat e plota të kësaj konference mund t’i gjeni në lidhjen web: www.neuroradiologia.unibo.it/testi.htm).

Aktualisht, qendra e Njësise është vendosur pranë Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë së Tiranës, Institucion në të cilin japin kontributin e vet akademik edhe dy prej anëtarëve të Njesisë.

Gjatë vitit të parë të aktivitetit të saj Njësia i fokusoi përpjekjet në konsolidimin e vet struktural, në komunikimin me Institucionet shqiptare të angazhuara direkt apo indirekt në fushën e bioetikës dhe në analizën e mjedisit social shqiptar për të identifikuar fushat e veprimit më efikas.

Në kete periudhe kohe Njësia u përfaqësua gjithashtu në Kongresin VIII të Rrjetit të Bioetikës UNESCO-s organizuar në Tiberias, Izrael (shtator 2012), në International Congress of Bioomedical Sciences (Tiranë, maj 2013) dhe për gatitet të paraqitet në Kongresin Botëror të Bioetikës në Napoli (19-21 nëntor 2013).

Është e rëndësishme të nënvizohet fakti se Njësia Shqiptare e Bioetikës e Rrjetit Nderkombëtar të Bioetikës UNESCO, nuk ka raporte varësie ndaj asnjë institucioni qeveritar apo jo-qeveritar në Shqipëri.

Si pjesë organike e rrjetit ndërkombëtar të Bioetikës UNESCO, Njësia Shqiptare, ka si qëllim kryesor promovimin e edukimit bioetik në të gjitha shtetet e formimit të kuadrove mjekësore dhe paramjekësore, duke synuar kryesisht formimin në nivelin universitar, si baza e forcimit të rolit të etikës në ushtrimin e përditshëm të profesionit të mjekësisë në Shqipëri.

Aktiviteti i saj do të synojë propozimin e modeleve të mësimdhënies së etikës mjekësore në fakultetet e mjekësisë, modele të miratuara nga katedra perkatese të UNESCO-s, plotësimin e kurrikulave universitare me koncepte bazë të bioetikës, trajnim të pedagogëve përgjegjës për mesimdhënien e etikës mjekësore në fakultetet e mjekësisë, aktivitete informuese për personelin mjekësor, etj.

Per arritjen e objektivave të saj, Njësia do të bashkepunojë natyrshëm dhe aktivisht me të gjitha ato ente dhe organizma shqiptarë apo të huaja, aktive në fushën shëndetësore, universitare, edukative apo politike-berese; jo mirepret gjithashtu ide bashkëpunimi të cilat kanë për qëllim rritjen dhe forcimin e vlerave etike si pjesë themelore në edukimin e profesionistëve të mjekësisë dhe në ushtrimin etik të këtij profesioni në Shqipëri.

Aktiviteti i Njësive të Shqipërisë dhe Maqedonisë, pjesë e Rrjetit Ndërkombëtar të Katedrës së Bioetikës së UNESCO-s, janë një tjetër shembull i veprimtarisë ndërkombëtare të Institutit Alb-Shkenca dhe i potencialit intelektual të këtij Instituti në rritjen dhe promovimin e shkencës dhe kultures shqiptare, përmes krijimit të urave të bashkëpunimit mes komunitetit shkencor që vepron në trojet shqipfolëse të Ballkanit, si pjesë e komunitetit intelektual ndërkombëtar.